

KËRKESË
Nr. 3753/1, datë 18.10.2019

**PËR RIHAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT, PËR T'U
PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T'I PROPOZOHEK KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, PËR T'U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË AUTORITETIN E KONKURRENCËS**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë **nr. 3092/1 prot.**, datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent, për të siguruar përzgjedhjen e kandidatit/tëve me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion, vendosi:

Hapjen e procesit për çdo të interesuar, që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.

Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9121/2003, Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen nga Kuvendi, **me kandidatura alternative**, ku një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës.

Shpallja dhe administrimi i kandidaturave qëndroi i hapur për një afat 10-ditor, nga data 23 shtator–3 tetor 2019.

Në vlerësim të faktit, se brenda afatit të shpallur për aplikim nuk u sigurua numri i nevojshëm i kandidatëve, për të përzgjedhur ndërmjet tyre kandidaturat alternative të përshtatshme për t'iu propozuar Kuvendit, Presidenti i Republikës ka vendosur: **Rishpalljen e procesit për shprehjen e interesit, për t'u përzgjedhur si kandidat që do t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë, për t'u zgjedhur në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës.**

Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë nga data e sotme 18 tetor deri në datën 25 tetor 2019, ora 12:00.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, që të marrë pjesë në këtë proces publik e të shprehë interesin për të qenë kandidat për anëtar të Komisionit të Konkurrencës, të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën për shprehjen e interesit;
- jetëshkrimin në gjuhën shqipe me të dhënat e plota të kontaktit;
- kopje të noterizuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve për t'u zgjedhur në këtë pozicion, të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si:
 - të jetë shtetas shqiptar;
 - të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;
 - të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti "E drejtë civile/administrative";
 - të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në mjediset e selisë së Presidentit, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista totale e personave, të cilët kanë shprehur interesin do të bëhet publike në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Kandidatëve të përzgjedhur do t'u kërkohej paraqitja e dokumentacionit shtesë si më poshtë:

- formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar dhe nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- formularin e aplikimit, të plotësuar: "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

- vetëdeklarim i aplikantit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit, sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

Propozimi, që Presidenti i Republikës do t'i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.